



Me 1 Tetor 2015, QAPA dhe GIZ (Die Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nënshkruajnë Marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e Projektit "FUQIZIMI DHE OPERACIONALIZIMI I AKTIVEVE PROFESIONALE - ZHVILLIMI I NJË DORACAKU PËR FUQIZIMIN DHE OPERACIONALIZIMIN E AKTIVEVE PROFESIONALE

SYNIMI I PROJEKTIT:

Projekti synon që nëpërmjet bashkimit dhe integritit të mësimdhënësve të bazuar në KKK, të krijohet një Komunitet i Fuqishëm i të Nxënësve i cili do kontribuojë që EB në Kosovë t'i përfitojë përmasat e arsimit të shekullit XXI dhe të jetë ekuivalent me vlerat dhe arritjet e BE.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT:

1. Të rrisë shkallën e vetëdijes të komunitetit arsimor për rolin dhe rëndësinë që kanë bashkimet profesionale të mësimdhënësve për avancimin e cilësisë së AB në Kosovë
2. Të ekzaminojë – diagnostikojë gjendjen e tashme të punës së Aktiveve Profesionale në pesë komuna /përfshirë edhe Gjakovën dhe Drenasin/
3. Të identifikojë mekanizmat, format dhe metodologjitë për fuqizimin dhe operacionalizimin e AK dhe AMKAF
4. Të hartojë Doracakun për Fuqizimin dhe Operacionalizimin e AP & AMK
5. Të zhvillojë një Studim për Vlerësimin Rapid të Efekteve të Projektit - SVREP

6. Organizmi i një Konferencë për prezantimin e efekteve të projektit

PRITSHMËRITË

1. Vetëdija e shtuar për rolin dhe rëndësinë që ka KN
2. Përgjegjësia, transparenca dhe llogaridhënia e avancuar
3. Rritja e shkallës së demokratizimit të edukimit, arsimit dhe të aftësimit në EB
4. Rritja e etosit të institucioneve të EB
5. Rritja e dobisë që qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike, racore, gjuhësore, gjinore, mosha dhe dallimet tjera do t'i kenë nga edukimi dhe arsimit cilësor.